

AKT THEMELIMI
Per krijimin e shoqerise "SHPRESA" shpk



Sot me daten 3/2/2002 :

Lush Osmani i biri i Prenges, dtl.1946, me banim ne tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

Personi fizik i siperpermendur, me vullnetin e tije te lire dhe ne pajtim me legjislacionin shqiptar ,krijoj shoqerine me pergjegjesi te kufizuara (SH.P.K.) me emertimin "SHPRESA".

NENI 1.

Administratore i kesaj shoqerie eshte Lush Osmani.

Shoqeria ka te drejte te krijoj filiale te saj brenda dhe jashte vendit ne cdo kohe qe do te cmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

NENI 2.

Shoqeria "SHPRESA " shpk gezon statusin e personit juridik. Veprimtaria e saj do te zhvillohet sipas dispozitave te kesaj kontrate, statutit te saj dhe legjislacionit ne fuqi. Qendra e saj eshte ne Kamez. Statuti i shoqerise i bashkengjitet kesaj kontrate dhe eshte pjese perberese e saj.

NENI 3.

Veprimtaria e shoqerise si person juridik fillon me aprovimin e krijimit te saj nga organet kompetente dhe dhe do te vazhdoj per nje periudhe kohe mbi dhjete vjet.

Shoqeria mbaron aktivitetin e saj me kalimin e afatit te parashikuar ne kete kontrate, neqoftese themeluesi me vullnetin e tije te lire nuk e zgjasin kete afat.

NENI 4.

Shoqeria "SHPRESA" shpk do te kete si objekt:

Transport mallrash dhe pasagjeresh brenda dhe jashte vendit. Tregtim me shumice dhe pakice artikuj te ndryshem industrial, ushqimor, pajisje elektroshtepiake dhe elektronike, konfeksione, kinkalerie, materiale ndertimi, vegla pune , fruta perime, ushqimore,produkte bujqesore,-blektorale,makineri, vegla bujqesore, vajra lubrifikante ne menyre stacionare,distributor dhe ambulant.Tregtim me pakice karburante, produkte mishi te ndryshme,sallameri si dhe import dhe eksport te tyre, inerte te llojeve te ndryshme, materiale ndertimi, pajisje e makineri, rrobagespi cilile dhe ushtarake ,perpunim i lendes drugore, dru zjarri,tregti tekstile,bizhuteri, shitblerjen e tyre brenda dhe jashte vendit.

NENI 5.

Kapitali themeltar i kesaj shoqerie eshte 100.000 Leke,ne te cilen merr pjese ortaku i vetem ne masen 100%.

NENI 6.

Fitimi neto qe do te realizohet nga veprimtaria e kesaj shoqerie i perket ortakut te vetem te saj.

NENI 7.

Per detyrimet qe do te krijohen ndaj personave te trete gjate aktivitetit te kesaj shoqerie, kjo shoqeri pergjigjet vetem me kapitalin e saj. Ortaku nuk mban pergjegjesi per detyrimet e shoqerise me pasurine e tije qe nuk ben pjese ne kapitalin e kesaj shoqerie.

NENI 8.

Mardheniet e punes ne shoqeri ose ne filialet e saj rregullohen nepermjet kontrates se punes.

NENI 9.

Dispozita te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.

Themeluesi si lexoi aktin dhe e gjeti konform vullnetit te tije nenshkroi ne pranine time dhe une noterja legalizoj nenshkrimin sipas ligjit.

ORTAKU THEMELUES

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Notere Mimoza Shehu
Nr. 1301 rep.
Nr. Kol.



V E R T E T I M

Sot me daten 13.6.2002 ne zyren e Noterise Tirane, perpara meje Noteres Mimoza Shehu u paraqite personalisht themeluesi i shoqerise sa siper i cili deklaroi se ky akt eshte redaktuar sipas vullnetit te tije e nenshkroi ne pranine time dhe une noterja legalizoj nenshkrimin sipas ligjit.